



Mirësevini në buletinin e 4-rt informativ të projektit EnerNETMob Interreg MED!

Ngjarjet kryesore në EnerNETMob

Një artikull i ri i botuar nën projektin EnerNETMob

Artikulli me titull "Eksplorimi i fizibilitetit të futjes së automjeteve elektrike në transportin e mallrave në zinxhirin e shkurtër të furnizimit me ushqim: Një qasje me shumë aktorë" është botuar në revistën "Raste Studimore për Politikën e Transportit", nga UNIPA - partner në projektin EnerNETMob.

Përditësime mbi zbatimin e projekteve pilot

UNIPA nënshkruan Marrëveshjen me Komunitet e Troina dhe Acireale dhe "Rete Fattorie Sociali Sicili" për të filluar fazën e tretë të aksioneve pilote të projektit

Më 9 mars 2021, u nënshkrua një marrëveshje midis Departamentit të Shkencave Bujqësore, Ushqimore dhe Shkencave Pyjore të Universitetit të Palermos, partner i projektit, dhe Bashkive të Troina dhe Acireale si edhe "Rete Fattorie Sociali Sicili", duke shpallur zyrtarisht fillimin e fazës së 3-të të aksioneve pilote të projektit "Shërbimet Logjistike të Elektromobilitetit të Qytetit" me synim vlerësimin, nga pikëpamja ekonomike dhe mjedisore, e mundësive për përhapjen e mobilitetit elektrik në zinxhirin e shkurtër të furnizimit me ushqim.



Konsorciumi i Bashkive të Raguzës vazhdon rrugën drejt mobilitetit të qëndrueshëm

Prillin e shkuar, flota e makinave të Konsorciumit të Bashkive të Raguzës - partner në projektin EnerNETMob, u pasurua me dy makina plotësisht elektrike të blera në kuadër të projektit EnerNETMob.



ENA dhe Bashkitë e Setúbal, Palmela dhe Sesimbra paraqesin Strategjinë e Elektromobilitetit për territorin e Arrábida

Plani i Elektromobilitetit të Arrábida-s është rezultat i punës së përbashkët të partnerit të EnerNETMob ENA - Agjencia e Energjisë dhe Mjedisit e Arrábida, dhe Bashkive të Setbal, Palmela dhe Sesimbra në kuadër të projektit EnerNetMob.

Takimet & eventet e projektit EnerNETMob



EnerNETMob në Panairin e Projekteve Evropiane, Mali i Zi

Më 29 maj, Partneri i EnerNETMob, Porti i Tivarit, mori pjesë në Panairin e Projekteve Evropiane të organizuar nga Dhoma e Tregtisë e Tregtisë e Mali të Zi si pjesë e krenimit të Evropës.

Takimi i 7-të Transkombëtar i EnerNETMob

Takimi i 7-të i Komitetit Drejtues të projektit u zhvillua online në 1 Qershor. Të gjithë partnerët morën pjesë në takim për të diskutuar progresin e projektit dhe planet e ardhshme.



SHËNONI DATËN: "Forumi i 4-rt European i Energjisë për Mobilitetin Smart"

Le të takohemi në edicionin e 4-rt të eventit european referues mbi zgjidhjet e energjisë për mobilitet të qëndrueshëm në 6 - 7 tetor në Marsejë! EnerNETMob dhe partneri Capenergies, bashkë-organizator i këtij eventit 2-ditor, ju ftojnë të takohemi, shkëmbejmë ide dhe ndërtojmë së bashku zgjidhje inovative të energjisë për përhapjen e mobilitetit të pastër: zgjidhje elektrike dhe hidrogjeni, por edhe biogaz dhe bio-GNV, për transportin tokësor, detar dhe ajror.

Bashkohuni me rrjetin EnerNETMob

EnerNETMob numëron 16 partnerë nga 12 vende Mesdhetare: Greqia, Malta, Italia, Qipro, Shqipëria, Kroacia, Sllovenia, Portugalia, Mali i Zi, Spanja, Franca dhe Austria, të cilët nxisin rritjen e zgjidhjeve të elektromobilitetit në rajonin e Mesdheut.

Facebook: @enernetmob Twitter: @EnerNETMob

Mësoni më shumë për EnerNETMob enernetmob.interreg-med.eu

Map of Europe showing partner locations with a legend listing various regional and national organizations like Capenergies, ENA, RAM, and others.